



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:119807

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05755380

KF.nr.377/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Gentipharm” Sh.P.K., me seli në Parkun e Biznesit, Drenas, Magjistralia Prishtinë-Pejë, përfaqësuar nga Avokat Rafet Ferizi nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, baza juridike rivlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 14.05.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Avokatit Rafet Ferizi dhe përfaqësuesit të palës së paditur Xhafer Krasniqi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Gentipharm” Sh.P.K., me seli në Parkun e Biznesit, Drenas, Magjistralia Prishtinë-Pejë.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/641/2018 të datës 14.05.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Gentipharm” Sh.P.K., me seli në Parkun e Biznesit, Drenas, Magjistralia Prishtinë-Pejë t’ia kthej shumën prej 902.48 € (nëntëqindën e dy euro e dyzetë e tetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-57237 i datës 27.09.2018 dhe R-61082 i datës 15.10.2018, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e pranimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën e plotë.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Gentipharm” Sh.P.K., me seli në Parkun e Biznesit, Drenas, Magjistratja Prishtinë-Pejë, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 14.06.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet si i pabazuar Aktvendimi i të paditurës dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara më tepër me rastin e ri-vlerësimit doganor të mallit si dhe të paguaj shpenzimet e procedurale në emër të detyrimeve të importit mbi vlerën e transaksionit. Gjatë seancës së fundit të shqyrtimit kryesor publikë të datës 14.05.2024 përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbasin në tërësi pran padisë dhe kërkesëpadisë të parashtruar në gjykatë lidhur me anulimin e aktit administrativ të Doganës me nr.01.3.2.2/641 me të cilin aktvendim Dogana e Kosovës duke e mënjanuar edhe vet nenin 33 të Kodit Doganor të Kosovës gjatë rivlerësimit të mallrave të importuara ka mbingarkuar me vlerë 902.48 Euro më tepër duke mos marr për bazë ankesën e paraqitur ndaj vendimit fillestar si dhe udhëzimet apo urdhrat e gjykatës të cilin e ka anuluar këtë vendim dhe e ka rikthyer në rivendosje. Tutje ka shtuar se neni 33 i Kodit Doganor në mënyrë decidive e parasheh si metodë të parë të përcaktimit të vlerës doganore të mallrave të importuara, transaksionet bankare dhe faturat në mes të subjekteve juridike. Ka shtuar se e paditura nuk ka marr për bazë faret, dëshmitë e paraqitura për të vlerësuar saktë vlerën e mallrave të importuara. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se me aktgjykimin me të cilin është anuluar ky akt dhe ka obliguar të paditurën që të shqyrtoj pretendimet dhe provat si dhe dokumentacionin e përcjell lidhur me mallin e doganor, edhe pse këto detyra të dhëna me aktgjykim kanë qenë obligative për të paditurën asnjë nga këto nuk i ka përfill dhe ka ardhur prapë në nxjerrjen e vendimit të njëjtë të kundërligjshëm dhe pa bazë ligjore. Ka shtuar se si pretendim dhe provë e mjaftueshme që është dashur që të marr parasysh e paditura në rishqyrtim e kësaj çështje është fakti se shitësi i mallrave të importuara nga paditësit është kompani e licencuar në Gjermani për shitjen e automjeteve, subjekti juridik me të gjitha të dhënat e biznesit ku fare lehtë ka qenë që nga e paditura të bëhet verifikimi i vlerës së saktë të produkteve të importuara. Gjykatës i ka propozuar që të nxjerr aktgjykim me të cilin anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës, çështje të mbyllet si e gjykuar dhe ka kërkuar që të detyrohet e paditura të ia kthej shumën prej 902.48 Euro në emër të pagesë në rastin e rivlerësimit doganor të automjetit me kamat ligjore si dhe të paguaj të gjitha shpenzimet gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi të datës 23.11.2021 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin konstuese si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se mbesin në tërësi sipas përgjigjes në padi, thëniet e evidentuar në procesverbalin e kësaj gjykate duke shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit të thëna në padi dhe gjatë kësaj seance gjyqësore, në lidhje me interpretimin e nenit 33 të KDA për të iu pranuar vlerësimi i mallit sipas metodës së parë gjegjësisht vlerës së transaksionit. Tutje ka shtuar se pretendimi i paditësit në vështrim të kësaj dispozite është pa bazë juridike për arsye se me rastin e deklarimit të mallit e paditura ka shikuar mallin dhe dokumentacionin dhe në bazë të konstatimit të gjendjes faktike ka konstatuar se nuk mund ti pranohet vlera e transaksionit për arsye se sipas të dhënave të krahasueshme që i disponon e paditura paditësi ka paraqitur vlerë më të ultë. Ka cekur se e paditura ri vlerësimin e mallit kontestues e ka mbështetur në bazë të katalogut SCHWACKE e që është një dokument i besueshëm i një shteti të besueshëm të BE-së, të Gjermanisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se pretendimi i paditësit se e paditura lehtë ka mundur të verifikojë çmimin e mallit tek shitësi është pretendim i pa bazuar dhe pa bazë juridike sepse e paditura në këtë çështje administrative askund nuk ka konstatuar se paditësi ka paguar vlerë tjetër nga ajo që ka deklaruar, por e paditura i ka kontestuar vlerën në kuptim të vlerësimit të mallit për qëllime të taksave doganore, andaj nga kjo i propozojmë gjykatës që të refuzojë padinë dhe kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 14.05.2024, ka administruar provat si në vijim: DUD-at kontestues, Faturat 1907, 2109/2018, Urdhërpagesat ndërkombëtare, Aktvendimi nr. 01.3.2.2/641 i datës 29.11.2018, Aktgjykim A.nr. 44/2019, Aktvendimi nr. 01.3.2.2/641/2018 i datës 14.05.2021, Foto dokumentacioni, Faturë 605/18 dhe kuponi fiskal, Faturë 18178, Urdhërpagesa, Ankesë e datës 08.01.2019 dhe Kërkesë për kthimin e mjeteve datës 24.10.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura në rivendosje ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se Zyra e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, kjo për arsye se është deklaruar vlera më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka të t'u paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Një veprim i tillë i Zyrës konsiderohet i drejtë pasi që është i bazuar edhe në shënimin e lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i datës 18.02.2024 dhe protokolluar me datë 19.02.2014 i cili me qëllim të eliminimit të përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit jo zyrtar, gjithë duke u bazuar në Kodin Doganor dhe të Akcizave, pa rënë ndesh me rregullat e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë, ka fuqizuar formën dhe vlerësimin e mallit duke përdorur si pikë referimi Katalogun Schwacke List që është në përputhje me nenin 36 të Kodit Doganor dhe Akcizave. Lidhur me dokumentacionin përcjellës Dogana e Kosovës sqaron se për mallrat që vijnë nga një vend eksportues dhe përkundër marrëveshje të asistencës reciproke me vendin tonë, procedura e verifikimit të mëpasëm të origjinalitetit të deklaratës së furnitorit ose vërtetimeve të çmimit, ose saktësisë së informacionit të paraqitur në to është e vështirë për të marrë informacion apo verifikim për shkak të kërkesave të kufizuara dhe prioriteteve të vendosura nga administratat doganore të shteteve eksportuese.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet*

patjetër në formën e transferit të parave. Paguesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se “a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi pas analizimit të transfereve bankare, faturave të bashkangjitura si dhe DUD-ve, e sipas të cilave gjykata konstaton se në faturën e datës 19.09.2018 evidentohet shuma neto prej 3,781.51 € për DUD-in R-57237 e cila është e njëjtë me konfirmimin e pagesës në shumë 4,500.00 € ku nga kjo vlerë bruto vlera e TVSH 718.49 u kthehet prej blerësit, ndërsa nga fatura e prezantuar e datës 21.09.2018 evidentohet shuma prej 4,700.00 € për DUD-in R-61082, e cila është njëjte me konfirmim pagese në shumë prej 4,700,00 €.

Pas analizimit të faturave të datës nr.1907 të datës 19.09.2018 dhe nr.21.09.2018 të datës 21.09.2018 gjykata konstaton se çmimi në faturë është çmimi real i cili është paguar dhe kjo vërtetohet edhe me konfirmim të pagesës të faturave e që rezulton që çmimi të jetë paguar sipas vlerës e deklaruar.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ave, R-57237 dhe DUD-in R-61082, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 902.48 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor

nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka vërtetuar se pagesa nga fatura nr.1907 e datës 19.09.2018 e deklaruar me DUD-in R-57237 është realizuar përmes transferit ndërkombëtar me numër të referencës 455146198 me datën 20.09.2018 dhe se fatura nr.21.09.2018 në vlerë prej 4,700.00 €, e deklaruar me DUD-in R-61082 është paguar përmes transferit ndërkombëtar me numër të referencës 455246604, të datës 21.09.2018.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumente e prezantuar të paditurës lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratat unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuara dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 902.48 €, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes dudave kontestues të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtinë.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.377/22, datë 14.05.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.